

VENDIM
Nr. 56, datë 23.4.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “NISHOVA ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 1, germa “g”; 8 dhe 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Nishova Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Nishova Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 4/10, germa “a”, e paplotësuar.

Neni 9, pika 4/10, germa “b”, e paplotësuar.

Neni 9, pika 4/10, germa “c”, e plotësuar.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti, që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Nishova Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti